



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 106, datë 30.06.2021**

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI INVESTIMET, HUADHËNIEN DHE  
HUAMARRJEN E SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË  
PUBLIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe neneve 137-144 të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Miratimin e rregullores “Mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**